

së dhe atyre serbe, e braktisën fshatin dhe u strehuan në *Malet e Berishës/Berishine planine* më 26.07.1998. Katër ditë më vonë, më 30.07.1998, i biri Avdiu, së bashku me disa familjarë, shkoi fshehurazi në shtëpi për ta bindur të atin që të nisej me ta. Zeqiri refuzoi sërish të largohej nga shtëpia. Të nesërmen, më **31.07.1998**, nga mali përmbi fshatin e tij, Avdiu ka vërejtur se forcat serbe depërtuan në *Mëhallën Gashi* dhe filluan tu vënin zjarrin shtëpive. Në datën 2.08.1998, pjesëtarë të UÇK-së e kanë gjetur trupin e djegur të Zeqirit në brendi të shtëpisë së tij. Pranë kufomës së karbonizuar kishte shumë gëzhoja. Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Zeqirit në *Malet e Berishës/Berishine planine*. Pas mbarimit të luftës, më 9.06.2000, mbetjet mortore të Zeqirit janë rivarrosur në varrezat e Llapushnikut/Lapušnik.

**Burimi:** deklarata A.G, FDH-18009.

---

### **Sofije (Jetullah) Zeqiri**

(3.05.1945, shqiptare nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac, shtatë fëmijë)

### **Besim (Miftar) Zeqiri**

(10.05.1983, shqiptar nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac, nxënës)

### **Halim (Miftar) Zeqiri**

(20.05.1962, shqiptar nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac, bujk)

### **Kada (Miftar) Zeqiri**

(1.05.1965, shqiptare nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac)

### **Vahide (Miftar) Zeqiri**

(2.07.1977, shqiptare nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac)

### **Nazmije (Azem) Zeqiri**

(21.03.1973, shqiptare nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac)

Në mëngjesin e datës **2.08.1998**, kur forcat serbe filluan sulmin me bombardimin e fshatit **Shtuticë/Štutica**, Sofija rastisi të ishte në oborrin e shtëpisë së vet. Më të dëgjuar shpërthimet e predhave, ajo nisi t'i thërriste familjarët që të dilnin jashtë shtëpisë dhe të iknin sa më shpejt që ishte e mundur. Disa nga anëtarët e familjes arritën

që të dilnin dhe madje të largoheshin afro 50 metra nga shtëpia, kur një predhë ra afër tyre duke i qëlluar për vdekje Sofijen, djemtë e saj Halimin dhe Besimin, vajzat Kaden dhe Vahiden, si dhe bashkëshorten e Halimit, Nazmijen, e cila ishte në muajin e tetë të shtatzenësisë. Po atë ditë, që të gjithë u varrosën në varrezat e vjetra të Shtuticës/Štutica. Pas përfundimit të luftës, më 30.04.2000, mbetjet mortore të Sofijes, Halimit, Besimit, Kades dhe Vahides dhe Nazmijes janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Shtuticë/Štutica.

**Burimi:** deklarata F.Z, FDH-15603.

---

### **Kada (Miftar) Zabeli**

(1966, shqiptare nga Rezalla/Rezala, komuna e Skënderajt/Srbica, dy fëmijë)

Kur forcat serbe e sulmuan Rezallen/Rezale më 29.07.1998, Kadja me vajzën Shyhreten dhe djalin Fehmiun u strehuan te babai i Kades në fshatin Shtuticë/Štutica. Tri ditë më vonë, më **2.08.1998**, rreth orës 8:00, forcat serbe e nisën sulmin me bombardimin e **Shtuticës/Štutica**. Kadja sërish tentoi, së bashku me fëmijët dhe familjarë të tjerë, të largohet nga fshati. Por, derisa po kalonin pranë shtëpisë së komshiut tyre të parë, Mustafë Zeqiri, një predhë e ka qëlluar Kaden dhe fëmijët e saj. Ajo ndërroi jetë disa minuta më vonë nga plagët e rënda. Edhe pse ishin të plagosur nga predha, fëmijët mbijetuan. Kaden e kanë varrosur në varrezat e Shtuticës/Štutica.

**Burimi:** deklarata H.Z, FDH-14417.

---

### **Zymer (Osman) Mulaj**

(1.05.1972, shqiptar nga Shtuticë/Štutica, komuna e Glogocit/Glogovac)

Pas nëntë vjetësh të kaluara në Gjermani, Zymeri u kthye në vitin 1997 në **Tërstenik/Trstenik**, ku jetonte familja e tij. Vuante nga problemet psikike, ndërkaq gjendja e tij u përkeqësua pas fillimit të luftës. Në mëngjesin e datës **10.08.1998**, ai ka dal nga shtëpia dhe nga ajo ditë nuk ka asnjë gjurmë për të. Familja Mulaj është duke kërkuar ende ndriçimin e fatit të tij. Zhdukja e Zymerit është regjistruar nga